

EPPC Albania po kërkon një **Sales Team Lead** për klientin e saj, një ndër *kompanitë lider në tregun e printimeve dixhitale, veshjeve të punës dhe produkteve promovionale*.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Zhvillimi dhe ekzekutimi i strategjive të shitjes për të siguruar rritje të qëndrueshme dhe përmbushjen e objektivave të kompanisë;
- Menaxhimi, motivimi dhe zhvillimi i ekipit të shitjeve, duke ndërtuar një kulturë suksesi dhe inovacioni;
- Monitorimi i tregut dhe konkurrencës për të identifikuar mundësi të reja dhe zhvillim të portofolit të klientëve;
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e marrëdhënieve të forta me klientët ekzistues dhe partnerët strategjikë;
- Përdorimi i të dhënave të shitjeve dhe ndërtimi i databazave për optimizimin e strategjisë dhe vendimmarrjes;
- Negocimi dhe finalizimi i marrëveshjeve për të maksimizuar fitimet dhe për të rritur vëllimin e shitjeve;
- Bashkëpunimi me departamentet e tjera për të përmirësuar proceset dhe koordinimin ndër-sektorial;
- Zhvillimi i planeve operacionale dhe ndjekja e KPI-ve për të matur performancën dhe përmirësuar eficiencën;
- Përgatitja e raporteve të rregullta mbi aktivitetet dhe performancën e shitjeve.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare në **Administrim Biznesi, Marketing, Ekonomi** ose **fusha të ngjashme**;
- **Përvojë e maturuar në menaxhimin e shitjeve**, preferohet në sektorin B2B;
- Eksperienca në menaxhimin e të dhënave të shitjeve dhe platformave CRM;
- Përvojë në Power BI për analizë dhe raportim (e preferueshme);
- Aftësi drejtuese, fokus në rezultate dhe aftësi për të zbatuar strategji të efektshme;
- **Aftësi të mira komunikimi dhe negocimi** për të ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme me klientët;
- Fleksibilitet dhe aftësi për të operuar në një mjedis dinamik dhe konkurrues.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni aplikimin tuaj duke ndjekur linkun:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.
Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.